



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:124381

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05819245

2022:124382

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë e shkallës së parë penale e përbërë nga gjyqtarja e vetme gjykues Mimoza Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Vjosa Hasani, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.A me vendbanim në rrugën "S.Ç" ... në Ferizaj, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm me numër: PP.II.nr.837/22 e datës 16 Qershor 2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor fillestar dhe publik, në praninë e prokurorit të shtetit dhe të akuzuarit, me datë 29 Maj 2024 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 13 Qershor 2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

L.A, i lindur më ... në Ferizaj, nga i ati R.. e ëma A.., e gjinisë H.. me vendbanim në rrugën "S.Ç" ... si dhe rruga "... " nr... në Ferizaj, ka të kryer shkollën e mesme, beqar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 27.02.2022 rreth orës 10:45 në Ferizaj, në rrugën "S.Ç", saktësisht në barnatoren "B..", i pandehuri me dashje e dëmton pasurinë e të dëmtuarit N.H, në atë mënyrë që fillimisht e dëmton kabllon e reklamës dhe pastaj me shqelma e godet xhamin e derës së barnatores duke e thyer në tërësi, nga këto veprime të dëmtuarit i shkakton dëm material rreth 400.00 €.

- me të cilin veprim veprime ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-ës

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartë shënuar si dhe neneve: 2, 4, 7, 8, 17, 21, 38, 39, 69, 70, 71, 72, 81 dhe 82 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 364, 365, 369, 452, 462 të KPP-ës, të akuzuarit i shqipton,

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilën të akuzuarit i bëhet me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprë penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do ti shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

I dëmtuari N.H me vendbanim në Shtime rr.”...” nr.46 për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzetë /Euro, ndërsa në bazë të nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 dhe nenit 449 par.2 nënpar 2.9 të KPPK-së për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 20 Euro /njëzetë/, të gjitha brenda afatit prej 30 ditëve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, ose do të bëhet përmbarimi i detyruar sipas detyrës zyrtare.

A r s y e t i m

Historiku procedurës dhe aktakuza

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese në çështjen penale ndaj të akuzuarit : L.A vendbanim në rrugën “S.Ç” ... si dhe rruga “...” nr.8 në Ferizaj, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj e evidentuar me numër: PP/II.nr.837/22 të datës 16 Qershor 2022, duke vepruar në këtë çështje penale në bazë të nenit 240 të KPP-së (Kodi me numër 08/L-032), ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 29 Maj 2024, në prezencën e prokurorit të shtetit dhe të akuzuarit.

Gjyqtarja e vetme gjykuese pasi ka udhëzuar të akuzuarin në bazë të nenit 241 par.1 të KPP-së dhe pasi prokurori i shtetit ka lexuar aktin akuzues dhe pasi gjyqtarja u bind se i njëjti e ka kuptuar aktakuzën, në bazë të nenit 241 par. 4 si dhe pas njoftimit sipas dispozitave të neneve 321 dhe 319 të KPP-së, i ofroi mundësinë të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm, i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale që e ngarkon aktakuza andaj ka vazhduar me shqiptimin e dënimit ndaj të akuzuarit.

Pranimi i fajësisë nga i akuzuari

I akuzuari, në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë sipas të gjitha pikave të saj, është i vetëdijshëm për pranimin dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, shpreh keqardhje për këtë veprë penale, ka qenë një veprim i çastit, i ka kërkuar falje të dëmtuarit, kërkon nga gjykata që ti shqiptoj një dënim sa më të butë pasi që është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe i ka premtuar gjykatës që nuk do ta përsërit një veprim të tillë.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, gjyqtarja e vetëm gjykuese duke vepruar në pajtim me nenin 242 par.5 të KPRK-së, ka kërkuar mendimin e prokurorit të shteti.

Prokurori i shtetit, me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit sepse pranimi është bërë konform dispozitave ligjore nga neni 242 të KPPK-së pra në mënyrë vullnetare, kjo ka mbështetje edhe në provat materiale të shkresave të lëndës andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një dënim të paraparë me Kodin Penal të Kosovës, pasi që gjykata ta aprovoj pranimin e fajësisë i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit të marrë parasysh si rrethanat lehtësues ashtu edhe rënduese.

Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par.2 të KPP-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit si: deklarata e të dëmtuarit N.H në vendngjarje, e datës 27.02.2022, procesverbal për marrjen në pyetje të dëmtuarit N.H në Stacionin Policor Ferizaj, i datës 01.03.2022, procesverbali i intervistimit të pandehurit L.A i

datës 01.06.2022, raporti i oficerit së bashku me raportin shtesë me numër 2022-CF-337, i datës 27.02.2022, foto dokumentacioni, video incizimi si dhe shkresat e tjera të cilat gjenden në lëndë.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtarja në bazë të nenit 242 paragrafit 6 të KPPK-ës, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata po ashtu vërtetoi se prokurori ka disponuar me prova të mjaftueshme për veprën penale të të akuzuarit dhe ka dhënë mendimin për pranimin e fajësisë nga ana e tij.

Gjykata vërtetoi përtej çdo dyshimi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-ës, meqë me datë dhe vendin e lartcekur i pandehuri me dashje e dëmton pasurinë e të dëmtuarit N.H, në atë mënyrë që fillimisht e dëmton kabllon e reklamës dhe pastaj me shqelma e godet xhamin e derës së barnatores duke e thyer në tërësi, nga këto veprime të dëmtuarit i shkakton dëm material siç është përshkruar në aktakuzë, andaj për veprimet e ndërmarra i njëjti është shpall fajtor dhe është shqiptuar vërejtja gjyqësore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Caktimi i dënimit për të akuzuarin

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese përkatësisht që në shqyrtimi gjyqësor i akuzuari ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, kurse në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarin si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, ndërsa me rastin e vlerësimi të rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti në rastin konkretë.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata është e bindur se vërejtja shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit, duke marrë parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, duke vlerësuar se edhe me sanksion të posaçëm penal si vërejtja gjyqësore, me anë të së cilit kryesit i jepet qortim dhe i bëhet me dije se ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, andaj shqiptimi i saj është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës përkatësisht

vërejtja e shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Kërkesa pasurore juridike si dhe shpenzimet procedurale

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPP-së, pasi që nga të dhënat e mbledhura gjatë zhvillimit të procedurës nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërisht.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës gjyqësore është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 të KPPRK-së, ndërsa për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga arsyet e lartë shënuara u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm Penal

2022:124382 i datës 13 Qershor 2024

Bashkëpunëtorja profesionale,

Vjosa Hasani

Gjyqtarja,

Mimoza SHABANI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.